

U D H Ë Z I M

NR. 696 DATË 02.7.2015

**MBI RAPORTIMIN E INFORMACIONEVE TREMUJORE, VJETORE, NË  
FORMË ELEKTRONIKE NGA ANA E ZOTËRUESVE TË LEJEVE MINERARE**

Në zbatim të ligjit nr.10304, datë 15.7.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Urdhrit nr.308, datë 13.4.2011, "Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore, përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës, nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit, për grupin e mineraleve metalorë, jometalorë, qymyret dhe bitumet", Urdhrit nr.310, datë 13.4.2011, "Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore, përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës, nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit me karrierë për grupin e mineraleve ndërtimore".

**U D H Ë Z O N:**

1. Subjektet minerare, të pajisura me leje minerare të shfrytëzimit, informacionin e tremujorit të dytë për vitin 2015, duhet ta dorëzojnë personalishtë ose të përfaqsoar nga persona me autorizimin përkatës, pranë zyrës së protokollit të AKBN-së, si dhe të plotësojnë deklaratën bashkëlidhur këtij Udhëzimi.
2. Subjektet minerare, të pajisura me leje minerare të shfrytëzimit, raportimin e tremujorit të tretë, vjetor, për vitin 2015 dhe në vazhdim, duhet ta dorëzojnë në rrugë elektronike, në adresën <https://raport.akbn.gov.al>.
3. Mosrespektimi i këtij Udhëzimi, ngarkon me përgjegjësi subjektet minerare, ndaj të cilëve do merren masat administrative, parashikuar në ligjin nr.10304, datë 15.7.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.
4. Ngarkohet Drejtoria Minerare, Drejtoria e IT dhe Marrëdhëniet me Publikun, për ndjekje të këtij Udhëzimi.
5. Ky Udhëzim të publikohet në faqen zyrtare të AKBN-së.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**Dael DERVISHI**  
Drejtör Ekzekutiv